



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Punëtori / Punëtorja Kryetari / Kryetare President / President		Data e Punës / Data e Punës 30.11.2018	
Organizimi / Organizimi Org / Unit		Kryetari / Kryetare President / President	
SKPM SHCK		7242/2018	
		111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 322 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
2. Obligohet Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe
- Arkivit të Këshillit.


Eshref SHABANI
Kryetari i Këshillit





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primesht / Gorezuar Primesht / Prilozhenje Item / Attachment	30. 11. 2018	8	vit ed year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Rt. Prot. Rt. Prot. Prot. / Lt.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHC	7242/2018		11/12



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL
NË
GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË

PËR VITIN
2017

Prishtinë, 2018

Faqe 1 nga 12

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë”, Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
<https://kpmshc.rks-gov.net/>

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT	3
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES	3
FUSHAT E MBIKËQYRJES	4
RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË	5
I. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE	7
II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT	8
III. PROCEDURAT DISIPLINORE	9
IV. PROCEDURAT E ANKESAVE	9
V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT	9
VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE	10
VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT	10
VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	10
IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS	11
X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK	11
XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS	12
XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL	12
XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET	12
XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT	12
XV. SHËNIMET/KOMENTET/ PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL	12

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësi për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBBIMIN CIVIL NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Gjykata Themelore e Prishtinës përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 18.10.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimi me numër 03/2158 i datës 29.12.2015;
- Vendimi i datës 28.01.2016;
- Lista e pagave;
- Vendimi i datës 17.10.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
- Vlersimi punës për nëpunësen “Arkatare”;
- Vlersimi punës për nëpunësen “Sekretare Juridike”;
- Vllersimi punës për nëpunësen “Zyrtare Ligjore”;
- Vlersimi punës për nëpunësen “Zyrtare Shpenzuese-Zyrtare e të Hyrave”;
- Vllersimi i punës për nëpunësin “Zyrtar i TI-se”;
- Vlersimi i punës për nëpunësin “Zyrtar i Teknologjisë Informative për Përkrahje”;
- Vendimi i datës 24.08.2017 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi i datës 07.08.2017 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 28.01.2016 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës;
- Vendimi i datës 29.12.2015 për caktimin e Ushtruesit të Detyrës;
- Akt emërimi për nëpunësen “Zyrtare për Shpenzime”;
- Akt emërimi për nëpunësin “Çertifikues”;
- Konkursi i brendshëm Nr.2/2017;
- Njoftimi i datës 01.08.2017;
- Vendimi për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 18.09.2017 për pushim të lehonisë;
- Vendimi i datës 17.10.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
- Transferimi i datës 25.01.2017;
- Vendimi i datës 13.06.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës;

- Vendimi i datës 02.10.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Vendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës;
- Vijueshmëria në punë;
- Vendimi i datës 19.05.2017 për përfundimin e marrëdhënjes së punës për shkak të pensionimit;
- Vendimi i datës 02.06.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit;
- Kontrata për shërbime të veçanta.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Gjykatën Themelore në Prishtinë më datë 18.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës që nga data 04.01.2013.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjet e personelit, Kolegji ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën “Zyrtare për Shpenzime”, “Çertifikues” dhe “Zyrtar i Teknologjisë Informative për Përkrahje” dhe në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale ishin të kompletuara në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 Mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Në bazë të informatave të ofruara, është konstatuar që Gjykata Themelore në Prishtinë, ka pasur të caktuar tre (3) nëpunës si ushtrues të detyrës.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve për ushtruesit e detyrës, gjegjësisht Vendimin për caktimin e UD për pozitën Zyrtare Financiare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Vendimin për caktimin e UD për pozitën Zyrtarit Certifikues në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Vendimi për caktimin e UD për pozitën Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) në Zyrën për Buxhet dhe Financa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka konstatuar të gjeturat në vijim:

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me numër 03/2149 të datës 29.12.2015, në pozitën „Zyrtare Financiare” në Gjykatën Themelore në Prishtinë është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita “Ndihmës Zyrtare për Financa” Departamenti për Buxhet dhe Financa, nga data 01.01.2016 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me numër 03/2147 të datës 29.12.2015 në pozitën „Zyrtarit Certifikues” në Gjykatën Themelore në Prishtinë është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e “Zyrtar për Buxhet dhe Financa” Departamenti për Buxhet dhe Financa, nga data 01.01.2016 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit.

Me këto veprime Gjykata Themelore në Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafit 4 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Administratorin e Gjykatës, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për pozitat e lartcekura si dhe për çdo rast të caktimit të ushtruesit të detyrës.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve për ushtruesit e detyrës, gjegjësisht Vendimi për caktimin e UD për pozitën Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) në Zyrën për Buxhet dhe Financa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka konstatuar të gjeturën si në vijim:

Kolegji i Këshillit ka konstatuar që sipas Vendimit me numër 141/16 të datës 28.01.2016 në pozitën „Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF)” është caktuar ushtrues detyre, nëpunësi civil nga pozita e

“Zyrtarit për Buxhet dhe Financa”, nga data 28.01.2016 dhe ka qenë duke e vazhduar detyrën në këtë pozitë edhe në ditën e monitorimit, përveç tejkallimit të afatit ligjor për ushtrimin e detyrave të punës, Kolegji ka konstatuar se për vendin e punës „Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF)”, zëvendësimi i tij është dashtë të bëhet nga një udhëheqës tjetër.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Administratorin e Gjykatës, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe për zbatimin e dispozitave ligjore të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 37 të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, për pozitën e lartcekura si dhe për çdo rast të caktimit të ushtruesit të detyrës apo të zëvendësimit të nëpunësit civil.

II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në prishtinë gjatë vitit 2017 ka zhvilluar katër (4) procedura të rekrutimit: për vendin e punës “Këshilltar Profesional” i cili konkurs është vendosur si i rregulltë më vendin të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A/02786/2017 të datës 29.12.2017; pozita “Zyrtar Ligjor” i cili konkurs është vendosur si i rregulltë më vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A/02/243/2017 të datës 03.07.2017; pozita “Zyrtar për Operativ dhe Siguri” kjo pozitë është anuluar me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me numër A/02/159/2017 të datës 05.06.2017 si dhe për vendin e punës “Ndihmës Adminisrator” në Gjykatën Themelore Dega-Podujevë, edhe kjo pozitë është anuluar me vendin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A/02/112/2017 e datës 11.05.2017.

Marrvëshjet per shërbime te veçanta: Kolegji i Keshillit, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2017 ka pas tri (3) të angazhuar nëpunës me shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtar Ligjor” në Gjykatën Themelore në Prishtinë tri (3) vende të punës.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta ka konstatuar tri (3) marrëveshjet janë të lidhura për pozitën e shërbimit civil “Zyrtar Ligjor”.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarve: **„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.**

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet pasur parasysh që të njëjtat nuk mund të lidhen marrëveshje të tilla por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë në bazë të Vendimit me Nr. 1047/17 të datës 24.08.2017 ka të themeluar Komisionin Disiplinor dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se ky komision gjatë vitit 2017 nuk ka pas asnjë rast në shqyrtim.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

IV. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i themeluar me Vendimin Nr.981/2017 i datës 07.08.2017 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2017 në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë zhvilluar dymbëdhjetë (12) procedura të ankesave ndaj nëpunësve civil, prej të cilave tetë (8) janë vendosur me vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendimet: A/02/112/2017; A/02/159/2017; A/02/221/2017; A/02/242/2017; A/02/243/2017; A/02/474/2017; A/02/586/2017 dhe A/02/786/2017.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 05.06.2017 ka marrë vendimin me numër A/02/159/2017 me të cilin vendim është shfuqizuar vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me numër KA. 02/17 i datës 27.03.2017 me të cilin vendim Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka konstatuar që procedura e rekrutimit për vendin e punës “Zyrtar për Operativ dhe Siguri” në Gjykatën Themelore në Prishtinë është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit për shërbimin civil si dhe të rregullores për procedurat e rekrutimit. Këshilli me vendim me numër A/02/159/2017 të datës 05.06.2017 ka anuluar procesin e rekrutimit “Zyrtar për Operativ dhe Siguri” në Gjykatën Themelore në Prishtinë, i cili vendim është zbatuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil gjithsej janë mbete pa vlerësim të rezultateve të punës për vitin 2017, pesëdhjetë (50) nëpunës civil dhe në këtë institucion për vitin 2017 është bërë një vlerësim i periudhës provuese të nëpunësit civil brenda afatit të përcaktuar ligjor.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se nga dosjet personale të nëpunësve civil, pesëdhjetë (50) nëpunës civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk i'u është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2017.

Me këto veprime Gjykata Themelore në Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat nenit 3 të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Administratorin e Gjykatës Themelore në Gjykatë, që të ndërmarr veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve dhe që për të gjithë nëpunësit civil të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, mban evidencën e pushimeve të nëpunësve civil në kopje fizike. Gjatë vitit 2017 kanë shfrytëzuar pushime mjekësore gjashtëdhjetë (60) nëpunës civil, dy (2) pushim pa pagesë dhe shtatë (7) pushim i lehonisë.

Në bazë të vlerësimit të dosjeve dhe vendimeve përkatëse, është konstatuar që për pushimet e nëpunësve civilë, janë zbatuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë dhe në këtë fushë nuk është evidentuar asnjë shkelje.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore e prishtinës gjatë vitit 2017 ka pasur një (1) transferime të jashtme i përhersëhm, e cila është lidhur me marrëveshje me institucionet përkatëse sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, ka të punësuar 226 nëpunës civil prej tyre 205 shqiptar, 20 serb, 2 rom dhe 2 turqi, prej 226 nëpunësve civil 151 janë të punësuar femra ndërsa 75 janë meshkuj ndërsa në këtë institucion ka një (1) nëpunës civil të punësuar nga personat me aftësi të kufizuara, në këtë kuptim kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 226 nëpunësve civil të punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, 151 prej

tyre janë të punësuar femra ndërsa 75 janë të punësuar meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 226 nëpunësve civil të punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vetëm një (1) nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për respektimin e dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, tre (3) nëpunës civilë janë pezulluar, dy nëpunës kanë pushim pa pagesë dhe një nëpunës ka qenë më pezullim parandalues me 50% të pagës, mirëpo në vitin 2018 është kthyer në vendin e punës. Një (1) ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes dhe pesë (5) përfundime të marrëdhënies së punës janë bërë për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk ka asnjë nëpunës që është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore e Prishtinës, respektivisht zyra e personelit, nuk e ka planin e trajnimeve pasi që këtë e planifikon Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa shtesat apo kompensimet tjera realizojnë puna jashtë orarit të punës (ndërrimi i natës), dhe zyrtarët e Teknologjisë Informative.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, ka zbatuar të gjitha vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XV. SHËNIMET/KOMENTET/ PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lela Petković

Kryetare e Kolegjit

Valentina Kaçandolli Bektashi

Bashkëpunëtore Profesionale